



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPK</u>	Br. Prot. <u>03-02/319/18</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. i faq.	Data
Broj. stranca <u>02</u>	Datum <u>02-02-2018</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.02.2018, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2470/17, për znj. Lindita Kajtazi, Drejtoresh e Shërbimeve Shëndetësore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Lindita Kajtazi, Drejtoresh e Shërbimeve Shëndetësore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe njëkohësisht “person i autorizuar” në biznesin privat Ambulanca Internistike “Betogjeni – Med”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj është organizuar një takim me zyrtaren e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtarja e lartë është njoftuar me fakte se ushtrimi i funksionit menaxhues në biznes privat është i ndaluar neni (15 paragrafi 1) të Ligjit nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Zyrtarja e lartë, është deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmer veprimet e nevojshme me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuara nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/208/18) me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat të cekur më lartë. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

